



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PREFEKTI I QARKUT SHKODER**

Nr. 127/1 prot.

Shkodër, më 9.02..2024

**LËNDA: Mbi vendimin Nr.6 date.26.01.2024 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.**

**KESHILLIT BASHKIAK VAU-DEJES**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016 dt.2.10.2016 “Për Prefektin”, Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 23, pika 6, neni 54, germa n, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu II, neni 4, ligjit Nr.8308 date. 18.03.1998 “Për transportet rrugore” i ndryshuar, neni 15, VKM Nr.146 datë.26.02.1998 “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve” i ndryshuar, Materialit të dërguar nga Sekretari i Këshillit Bashkiak Vau-Dejës Nr.761prot datë.31.01.2024 “Dërgojmë dokumentacionin shoqërues të mbledhjes të këshillit Bashkiak Vau-Dejës të datës 26.01.2024”: shqyrtoi *VKB Vau-Dejës nr.6 dt.26.01.2024: “Mbi miratimin e linjave të rregullta rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve”*.

Prefekti ju autorizon të procedoni konform procedurave të mëtejshme ligjore,  
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**P R E F E K T I**

**Majlinda ANGONI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr. 06 Datë 26 . 01 2024

**“PËR MIRATIMIN E LINJAVE TË RREGULLTA RRETHQYTETËSE TË  
TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE”**

Mbështetur në nenin 23, pika 6, nenin 54, germa “n”, nenin 55, pika 2 të Ligjit 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Në nenet 15, 19 të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar; VKM nr.66, datë 07.02.2007 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.146, datë 26.02.1998 të Këshillit të Ministrave për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, i ndryshuar; Udhëzimin nr.5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, i ndryshuar, Këshilli i Bashkisë Vau Dejës:

**VENDOSI:**

I- Të miratojë rrjetin e linjave rrethqytetase, numrin e orareve për çdo linjë dhe tarifën e biletave për të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Vau Dejës.

1.Për miratimin e linjës së rregullt të transportit të udhëtarëve **Vau Dejës – Bushat**, nisja nga ora 06<sup>00</sup> - 19<sup>00</sup>, çdo orë; **kthimi nga Bushati** nga ora 06<sup>00</sup> -19<sup>00</sup> çdo orë.

Stacionet për këtë linjë të jenë në qytetin Vau Dejës tek sheshi Nëne Tereza (sipas Planimetrisë) dhe në njësinë administrative Bushat në Qendër të fshatit Bushat (sipas Planimetrisë).

2.Për miratimin e linjës së rregullt të transportit të udhëtarëve **Vau Dejës – Nënshat**, nisja nga ora 06<sup>00</sup> - 19<sup>00</sup>, cdo orë; **kthimi nga Nënshati** nga ora 07<sup>00</sup> – 19<sup>00</sup>, cdo orë.

Stacionet për këtë linjë të jenë në qytetin Vau Dejës tek Sheshi Nëne Tereza (sipas Planimetrisë) dhe në njësinë administrative Hajmel në qendër të fshatit Nënshat (sipas Planimetrisë).

3.Për miratimin e linjës së rregullt të transportit të udhëtarëve **Vau Dejës - Shllak** nisja nga ora 7<sup>00</sup> – 12:30<sup>00</sup> me 2 (dy) orare në ditë; **kthimi nga Shllaku** nga ora 09<sup>00</sup> – 14:30<sup>00</sup> me 2 (dy) orare në ditë.





Stacionet për këtë linjë të jenë në qytetin Vau Dejës tek sheshi Nënë Tereza (sipas Planimetrisë) dhe në njësinë administrative Shllak në qendër të fshatit Shllak (sipas Planimetrisë).

4. Për miratimin linjës së rregullt të transportit të udhëtarëve **Vau Dejës – Koman**, nisja nga ora 06<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> me 3 (tre) orare në ditë ; **kthimi nga Komani** nga ora 06<sup>00</sup>- 17<sup>00</sup> me 3 (tre) orare në ditë.

Stacionet për këtë linjë të jenë në qytetin Vau Dejës tek Sheshi Nënë Tereza (sipas Planimetrisë) dhe në njësinë administrative Temal në qendër të fshatit Koman (sipas Planimetrisë).

5. Për miratimin e linjës së rregullt të transportit të udhëtarëve **Vig – Vau Dejës**, nisja nga ora 06<sup>00</sup> – 14:30<sup>00</sup>, me 4 (katër) orare në ditë, **kthimi ng Vigu** nga ora 08<sup>00</sup> – 16<sup>00</sup> me 4 (katër) orare në ditë.

Stacionet për këtë linjë të jenë në qendër të fshatit Vig (sipas Planimetrisë) dhe në njësinë administrative Vau Dejës në qytetin Vau Dejës tek sheshi Nënë Tereza (sipas Planimetrisë).

6. Për miratimin e linjës së rregullt të transportit të udhëtarëve Mnelë e Vogël – Bushat, nisja nga ora 06:30<sup>00</sup> me 1 (një) orar në ditë; **kthimi nga Bushati** në orën 14<sup>00</sup> me 1 (një) orar në ditë.

Stacionet për këtë linjë të jenë në qendër të fshatit Mnelë e Vogël (sipas Planimetrisë) dhe në njësinë administrative Bushat në qendër të fshatit Bushat (sipas Planimetrisë).

7. Për miratimin e linjës së rregullt të transportit të udhëtarëve **Bushat – Hajmel**, nisja nga ora 07<sup>00</sup> – 16<sup>00</sup> cdo orë; **kthimi nga Hajmeli** nga ora 08<sup>00</sup> – 17<sup>00</sup> cdo orë .

Stacionet për këtë linjë të jenë në qendër të fshatit Bushat (sipas Planimetrisë) dhe në njësinë administrative Hajmel në qendër të fshatit Hajmel (sipas Planimetrisë).

8. Për miratimin e linjës së rregullt të transportit të udhëtarëve **Koman – Bushat**, nisja nga ora 07<sup>00</sup> – 15<sup>00</sup> me 2 (dy) orare në ditë; **kthimi nga Bushati** në orën 08<sup>00</sup> – 17<sup>00</sup> me 2 (dy) orare në ditë.

Stacionet për këtë linjë të jenë në qendër të fshatit Koman (sipas Planimetrisë) dhe në njësinë administrative Bushat në qendër të fshatit Bushat (sipas Planimetrisë).

9. Për miratimin e linjës së rregullt të transportit të udhëtarëve **Vau Dejës – Spathar**, nisja nga ora 06:30<sup>00</sup> – 16<sup>00</sup> me 4 (katër) orare në ditë; **kthimi nga Spathari** në orën 07<sup>00</sup> – 17<sup>00</sup> me 4 (katër) orare në ditë.

Stacionet për këtë linjë të jenë në qytetin Vau Dejës tek sheshi Nënë Tereza (sipas Planimetrisë) dhe në qendër të fshatit Spathar (sipas Planimetrisë).

10. Për miratimin e linjës së rregullt të transportit të udhëtarëve **Pistull – Paçram** nisja nga ora 07<sup>00</sup>- 12<sup>00</sup> me 2 (dy) orare në ditë; **kthimi nga Paçrami** në orën 09<sup>00</sup> – 14<sup>00</sup> me 2 (dy) orare në ditë.

II- Në rrjetin e linjave rrethqytetase të lejohet përdorimi i autoveturave me 8+1 vende sipas paragrafit të katërt i nenit 19 të ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar.

III- Miratimin e tarifave të biletave të transportit rrethqytetase sipas gurmës ç të nenit 10 të ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar; VKM nr.85, datë 08.02.2017 “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”; VKM nr.66, datë 07.02.2007 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.146, datë 26.02.1998 të Këshillit të Ministrave për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, i ndryshuar;; Udhëzimin nr.3743, datë 10.07.2017 “Mbi modelet dhe standartet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”,

Përcaktimin e tarifës së transportit rrethqytetase për Bashkinë Vau Dejës si më poshtë:

1. Për linjat e transportit rrethqytetas me largësi nga 1-12 km

- a) Për biletën një përdorimëshe, vajtje ose kthim 100 (njëqind) lekë;
- b) Për biletë pajtimi mujor, për një linjë 1320 (njëmijë e treqind e njëzet) lekë;
- c) Për biletë pajtimi mujor, të përgjithshëm 2640 (dy mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë.

2. Për linjat e transportit rrethqytetas me largësi nga 12-17 km

- a) Për biletën një përdorimëshe, vajtje ose kthim 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë;
- b) Për biletë pajtimi mujor, për një linjë 1980 (njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë;
- c) Për biletë pajtimi mujor, të përgjithshëm 3960 (tremijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë.

3. Për linjat e transportit rrethqytetas me largësi nga 17-22 km

- a) Për biletën një përdorimëshe, vajtje ose kthim 200 (dyqind) lekë;
- b) Për biletë pajtimi mujor, për një linjë 2640 (dy mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë;
- c) Për biletë pajtimi mujor, të përgjithshëm 5280 (pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë.

4. Për linjat e transportit rrethqytetas me largësi nga 22-27 km

- a) Për biletën një përdorimëshe, vajtje ose kthim 300 (treqind) lekë;
- b) Për biletë pajtimi mujor, për një linjë 3960 (tre mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë;
- c) Për biletë pajtimi mujor, të përgjithshëm 7920 (shtatë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë.

5. Për linjat e transportit rrethqytetas me largësi nga 27-32 km

- a) Për biletën një përdorimëshe, vajtje ose kthim 350 (treqind e pesëdhjetë) lekë;



- b)Për biletë pajtimi mujor, për një linjë 4620 (katër mijë e gjashtëqind e njëzet) lekë;  
c)Për biletë pajtimi mujor, të përgjithshëm 9260(nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) lekë.

6.Për linjat e transportit rrethqytetas me largësi mbi 32 km


- a) Për biletën një përdorimëshe, vajtje ose kthim 600 (gjashtëqind) lekë;  
b)Për biletë pajtimi mujor, për një linjë 7920(shtatë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë;  
c)Për biletë pajtimi mujor, të përgjithshëm 15840(pesëmbëdhjetë mijë e tetëqind e dyzet)lekë.

***Në çmim përfshihet dhe TVSH-ja.***

Tarifat e transportit rrethqytetas të udhëtarëve me autobus , të indeksohen çdo vit në përputhje me zhvillimet social-ekonomike të vendit sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT.

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**

**Ardian CELEPIJA**



**Kryetar i Këshillit Bashkiak**

**Ervis SHIMAJ**



Miratuar me 20 vota

Vota Pro 20

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 31.01.2024